



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E AVOKATEVE TIRANE
STUDIO LIGJORE "PARTNERS CONSULTING" SHPK

Adresa: Rruga Komuna e Parisit, Njesia bashkiake numer 5, Vila 2, kati 1, Tirane

Nr. _____ - Prot

Tirane 04/07/2018

KONTRATE
Per Shitje kuotash

Ne Tirane ,sot ne daten 04/07/2018 ndermjet paleve te meposhte :

Shitsi : Z.Juanito Vako i biri i Gjergji dhe i dtl .09.05.1977 .Lindur ne Pogradec ,Banuese ne Tirane . I paisur me nr.personal **ID.H70509085J** me aftesi te plota juridike dhe per te vepruar

Blersi:Znj.Brunilda Mihaj e bija e Dylber dhe i dtl .30.01.1988 .Lindur ne Malas,Permet, Banuese ne Tirane . I paisur me nr.personal **ID.I85130001V** me aftesi te plota juridike dhe per te vepruar.

U nenshkrua kjo kontrat shitje kuotash si me poshte .

Me daten 09.01.2017 eshte rregjistruar Shoqeria "Partners Consulting" shpk me seli ne Tirane, Rruga Komuna e Parisit, Vila nr.2, Tirane(deri me date 22.08.2017 ka pasur adresen Rruga Komuna e Parisit, Pallati 6, Shkalla 2, Tirane) me objekt veprimtarie te saj:

-Sherbime konsulence ligjore dhe asistence per personat juridike dhe fizike ne fushen civile, penale, administrative, bankare, tregtare.

-Konsulence dhe informacion biznesi, konsulence per shoqerite tregtare.

-Sherbime konsulence financiare dhe fiskale, mbajtje kontabiliteti, bilanci etj.

-Mbledhje te kredive te keqija , perfaqesim ligjior dhe asistence gjate procedurave gjyqesore dhe te ekzekutimit te vendimeve gjyqesore.

-Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqipetar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufinjve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

-Rregjistruar ne QKB (ish QKR) me NIpt: **L71309040K**, me status aktiv dhe me kapital themeltar 100,000 (njqinde mije) leke me ortak te vetem **Z.Juanito Vako** e cila merr pjese ne shoqeri me 100% te Kapitalit ,1 kuote me vler nominale 100.000 (Njqind mije)leke.

BAZA LIGJORE

Kjo kontratë hartohet në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7850 , datë 29.07.1994 "Kodi Civil", i azhornuar.

OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate është, shitja e 1 (Një) kuote me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) Lekë, që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë të zotëruar nga ortaku i vetëm Juanito Vako dhe blerja e kësaj kuote nga Znj. Brunilda Mihaj .

Shitësi nëpërmjet kësaj kontrate deklaron se me vullnet të lirë dhe të plotë si dhe në bazë të legjislacionit në fuqi dëshiron që ti transferojë nëpërmjet shitjes kuotën si në paragrafin më sipër që ai disponon në kapitalin e kësaj shoqërie në favor të Znj. Brunilda Mihaj , e cila deklaron se është plotësisht dakort që të blejë këte kuotë që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë të zotëruar nga ortaku Juanito Vako .

ÇMIMI

Palët në marrëveshje të përbashkët kanë rënë dakort se çmimi i shitblerjes së kuotes që po transferohet nëpërmjet kësaj kontrate është si vijon:

100 % e kapitalit që zotërohet nga ortaku i vetëm Z. Juanito Vako i shitet Znj. Brunilda Mihaj në vlerën 100.000,00 (njëqind mijë) Lekë.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Z. Juanito Vako nuk ka asnjë pretendim financiar ndaj blerëses, Znj. Brunilda Mihaj . Palët deklarojnë se nuk kanë dhe nuk do të kenë asnjë pretendim për këtë në të ardhmen. Dhe konkretisht Z. Juanito Vako deklaronë në përgjegjësinë e tij personale dhe ligjore se është likujduar para nënshkrimit të kësaj kontrate, nuk ka asnjë pretendim financiar kundrejt blerëses, sot, apo në të ardhmen.

HARTIMI I KONTRATËS

Kjo Kontrate u redaktua ne 3(tre) kopje , përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, nje kopje do të depozitohet në Q.K.B.

PALA SHITSE

Z. JUANITO VAKO



PALA BLERESE

Znj. BRUNILDA MIHAJ